



Prishtinë: 01.03.2013

Kodi i ZRRE-së: V\_510\_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_863\_09\_12

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_863\_09\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.01.2013.

**Në mbledhjen e mbajtur më 01 mars 2013 nxorri këtë:**

### VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin U.G. (I.T. shifra në KEK: DPR - 90047354), nga Besiana si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_863\_09\_12 i datës 25.09.2012.

### Arsyetim

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 08.01.2011 e ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR – 90047354 me faturë mujore të energjisë elektrike në vlerë prej 79,923.11 € për periudhën 12/2010. Pas kësaj fature konsumatori me datë 13.01.2011 ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për ndërrim/shqyrtim njehsori.

Me datë 18.01.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 282595 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 45012241. Pas ndërrimit të njehsorit elektrike punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtim njehsori me datë 28.01.2011 kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 282595, dhe gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se njehsori elektrik është jashtë kufijve matës.

Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK, me të cilën ka kundërshtuar faturën e muajit 12/2012. KEK me datë 29.09.2011 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e shqyrtimit nr.013122 e datës 28.01.2012.

Konsumatori me datë 11.10.2011 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 25.09.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin në shifrën DPR – 90047354 nga fatura me nr. 12100 e datës 08.01.2011, si dhe ka kërkuar nga KEK-u, që të ngarkoi konsumatorin për periudhën 12/2010 bazuar në shpenzimin e periudhës së njëjtë me njehsorin e ri elektrik 12/2011 e që është 868 kWh/muaj.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK me rastin e vendosjes së kësaj çështje, është bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike duke e shkarkuar konsumatorin nga fatura e muajit 12.2010, me ç'rast ka bërë shkelje të Kodit të matjes nga neni 5.11



duke e anuluar një faturë edhe pse fatura total është dashtë të bëhet korigjimi sipas përqindjes së pasaktësisë (-2.61%) e jo të anulohet në total. KEK, në ankesë ka theksuar se shkelja e nenit 5.11 të Kodit të matjes, rrjedha e energjisë elektrike dhe procesverbali i kalibrimit janë bazë e mjaftueshme për kundërshtimin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01 mars 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 5.11.1 të Kodit të matjes si dhe nuk ka marr për bazë procesverbalin e lëshuar nga qendra e kalibrimit i cili e vlerëson gjendjen e njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha pikave të kundërshtimit konstaton se KEK, me rastin e atakimit të këtij vendimi nuk ka ofruar prova bindëse me të cilën e vërteton faktin se konsumatori i ka shkaktuar humbje nga ajo çka thirret KEK në ankesën e saj.

Konstatimet e KEK, të theksuara në ankesë se DMK, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 5.11.1 të Kodit të matjes nuk qëndrojnë për faktin se defekti i shkaktuar në njehsorin elektrik është një kërcim i kilovatëve që i përket vetëm muajit 12/2010, e që është një vlerë e paparashikueshme prej 721,262 kWh/ muaj, ndërsa në bazë të analizave të bëra duke i krahasuar periudhat e njëjta kohore del se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për këtë pikë matëse është përafërsisht prej 1000 kWh/ për muaj, andaj është e palogjikshme të thirremi në dispozitën e theksuar me lartë pasi që defekti i këtij njehsori i përket vetëm këtij muaji e jo të një periudhe më të gjatë.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të theksuara në ankesë si rrjedha e energjisë elektrike dhe procesverbalit të kalibrimit, Bordi i ZRRE-së, ka bërë vlerësimin edhe të këtyre pikave, mirëpo nuk ka gjet ndonjë shkelje të bërë nga ana e DMK-së, pasi që nëse krahasojmë rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit del se konsumatori ka një shpenzim mesatar të energjisë elektrike për këtë pikë matëse përafërsisht prej 1000kWh/për muaj, e që nuk korrespondon fare me ngarkesën që ka bërë KEK, konsumatorit në faturën e muajit 12/2010. Gjithashtu sa i përket shqyrtimit të njehsorit elektrik nga ana e laboratorit të kalibrimit Bordi i ZRRE-së, konsideron se një konstatim i tillë vetëm sa e vërteton më tepër faktin se njehsori elektrik ka qenë në defekt në periudhën e muajit 12/2010.

Bordi i ZRRE-së, konsideron se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit U.G (I.T) me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura me nr. 12100 e datës 08.01.2011, si dhe ka kërkuar nga KEK-u, që të ngarkoi konsumatorin për periudhën 12/2010 bazuar në shpenzimin e periudhës së njëjtë me njehsorin e ri elektrik 12/2011 e që është 868 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se KEK, në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen saktë dispozitave ligjore cilat janë shkelë nga ana e DMK-së, me nxjerrjen e këtij vendimi, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 01.03.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_863\_09\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar